



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 220, Datë 23.10.2024

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “PARISOL” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38, pika 1, gërma “a” dhe 39, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13, dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1853 prot., datë 21.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “PARISOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “PARISOL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1853 prot., datë 02.09.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2MW dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 184, datë 12.09.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.09.2024 dhe 14.09.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 24.09.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE.
- Gjithashtu, me shkresën nr. 1927, datë 16.09.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për fillimin e kësaj procedure.

- Me shkresën nr. 1853/3 prot., datë 30.09.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1853/4 prot., datë 09.10.2024, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues për aplikimin.
- Me qëllim analizimin e këtij dokumentacioni, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 215, datë 14.10.2024, u vendos zgjatja e vendimmarrjes deri në 10 (dhjetë) ditë.
- Pas analizimit në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pikën 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “PARISOL” sh.p.k.:
  - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën me Nr. 10511 Rep., Nr. 4874 Kol., datë 28.12.2023;
  - Ka marrë miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së shoqërisë “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a. marrëveshjen e lidhjes së re nr. 6641/3 prot., datë 01.11.2022;
  - Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 24.08.2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltaik me fuqi 2 MW dhe ka dokumentuar në ERE fillimin e punimeve brenda këtij afati, duke depozituar dhe raportimin përkatës të bërë në organet përgjegjëse.
- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gëma “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka plotësuar jetëgjatësinë e pritshme për 49 vjet, por nga plani i saj i biznesit rezulton se vitet e parashikuara për gjenerimin e energjisë elektrike (jetëgjatësia ekonomike) janë 25 vjet, ndaj dhe afati i licencës do të jetë për 25 vjet.
- Shoqëria ka dokumentuar në ERE fillimin e punimeve të centralit dhe në referencë të përcaktimeve të nenit 9 të kontratës Nr. 10511 Rep., Nr. 4874 Kol., datë 28.12.2023, vlerësohet që në vendim të përcaktohet se ajo duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së licencuar brenda datës 28.09.2025. Ky vendim do të jetë objekt rishikimi nga ERE në rast se nuk fillon operimi brenda këtij afati dhe depozitohet një qëndrim i MIE-s në lidhje me vlefshmërinë e kësaj kontrate.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “PARISOL” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.
2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së energjisë elektrike jo më vonë se data 28.09.2025.
3. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria nuk fillon operimin e centralit brenda afateve të përcaktuara në nenin 9 të kontratës Nr. 10511 Rep., Nr. 4874 Kol., datë 28.12.2023 të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të depozitohet një qëndrim i MIE-s në lidhje me vlefshmërinë e kësaj kontrate.
4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “PARISOL” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**